



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME

Nr.Prot. 20
Indeksi J

Tiranë, datë 13.04.2018

DREJTORISË SË SHËRBIMIT TË TRUPIT DIPLOMATIK

Në vëmendje të : Z. Adhurim Saliu, Drejtor

Z. Shpëtim Spahiu, ish Titullar

Lënda : Raport përfundimtar auditimi «Mbi vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe aktet nënligjore të aktivitetit ekonomik, financiar të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Në zbatim të planit vjetor të auditimeve, Urdhërit të Ministrit të Punëve të Jashtme nr.538 datë 19.12.2017 “Për kryerjen e auditimit të Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomantik” dhe në zbatim të Programit të Punës të Drejtorisë së Auditimit të Brëndshëm Nr. 101 prot, datë 19.12.2017, u krye auditimi në këtë subjekt “Mbi përputhshmërinë me ligjet dhe aktet nënligjore të aktivitetit të DSHTD-së” nga 01.01.2015 deri më 31.12.2017. Auditimi u krye i plotë, nga specialistët e Drejtorisë së Auditimit të Brëndshëm Dashuri Shehu, Arta Bërdica, Gentian Xhavara dhe Florjan Haxhi. Periudha e Auditimit nga auditimi fundit të MPJ 01.01.2015 -30.12.2017.

Për periudhën e audituar titullar të kësaj Ndërmarrjeje kanë qënë:

Nga data 01.01.2015 dhe në vazhdim Z. Shpëtim Spahiu

Shefi i Sektorit të Administratës kanë qënë:

Nga data 01.01.2015 e në vazhdim Znj. Elida Jupi

Shefi i Sektorit të Administratës dhe Zbatimit sipas strukturës së fundit kanë qënë:

Nga data 01.09.2017 e në vazhdim nj.Znj Elida Jupi

Shefi i Sektorit të Planifikimit kanë qënë:

Nga data 01.01.2015 deri më 10.08.2017 Z. Servet Kanxha

